



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2678, datë 21.04.2016

“Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Albtelecom” sh.a. për të drejtën e përdorimit të frekuencave 2550-2570 MHz çiftuar me 2670-2690 MHz”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 21.04.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Albtelecom” sh.a. për të drejtën e përdorimit të frekuencave 2550-2570 MHz çiftuar me 2670-2690 MHz”.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja g, e nenit 8, nenet 62 deri 79 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*” (**ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në republikën e Shqipërisë”**);
2. Ligji Nr 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative”;
3. Vendimi Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” ;
4. VKM Nr. 300, datë 08.04.2015, për “Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 468, datë 30.05.2013, të Këshillit të Ministrave, për “Miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e Broadband-it””.
5. Vendimi Nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” i ndryshuar ;

6. Vendimi Nr. 635, datë 15.07.2015, i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin Nr.1252, datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave, të ndryshuar”;
7. Rregullore për Autorizimin Individual, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2395, datë 15.12.2013.
8. Vendimi i Këshillit Drejtues Nr. 2674, datë 07.04.2016 për “Miratimin e Raportit përmbledhës të KVO-së dhe Njoftimin e Fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz”, Ref. 6-2x5-6x5-2016.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Kopje e Faturave të pagesave të kryera nga sipërmarrësi “Albtelecom” sh.a.
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- si dhe,
duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N :

1. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin Nr. 2674, datë 07.04.2016, në përfundim të tenderit publik me procedurë të hapur, me objekt **“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz”, Ref. 6-2x5-6x5-2016** miratoi:
 - a) Raportin Përmbledhës të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në të cilin oferta e sipërmarrësit “Albtelecom” sh.a. identifikohet si ofertë fituese.
 - b) Njoftimin e Fituesit, sipas Shtojcës 18 - Formulari i Njoftimit të Fituesit.
2. AKEP, bashkëlidhur shkresës Nr. 550/8 Prot., datë 07.04.2016 i ka dërguar “Albtelecom” sh.a., Formularin e Njoftimit të Fituesit, Nr.550/7 Prot., datë 07.04.2016, sipas Shtojca 18, të përfshirë në dokumentacionin e tenderit.
3. “Albtelecom” sh.a. brenda afatit 7 (shtatë) ditë, nga data marrjes së Formularit të njoftimit të fituesit, njoftoi kryerjen e pagesave, të mëposhtme:
 - a. Çmimin prej 20% të vlerës të ofertuar në shumën 436,801 (**katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e një**) Euro, më datë 14.04.2016, në Llogarinë bankare me emërtim: Qeveria Shqiptare.
 - b. Pagesa vjetore (për 8 muaj) është **1,920,000 (Një milion e nëntëqind e njëzetë mijë.) Lekë** për përdorimin e frekuencave në 4 (katër) të drejta përdorimi nga 2x5 MHz secila, spektër i çiftuar, siç përcaktohet në Dokumentat e Tenderit, datë 14.04.2016.
 - c. Pagesa vjetore (për 8 muaj) është **8,467,200 (Tetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) Lekë** për tarifën e shërbimit për shërbimet e radiokomunikimit,

në 4 (katër) të drejta përdorimi nga 2x5 MHz secila, spektër i çiftuar, siç përcaktohet në Dokumentat e Tenderit, datë 14.04.2016 dhe 15.04.2016.

Pagesa sipas pika a) të mësipërme, është kryer në Bankën e Shqipërisë, *Qeveria Shqiptare* në EUR me Nr: AL89 1011 1008 0000 0000 2111 001E .

Pagesat sipas pika b) dhe c) të mësipërme, janë kryer në llogarinë bankare të AKEP, me Nr: AL02 2021 1013 0000 0001 0000 4670, AL37 2121 1016 0000 0000 0000 4104, AL30 21 411 2090 1111 1386 9030 117.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për "Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, gërma g, neni 8, nenet 62 deri 79, neni 114 dhe neni 115;
2. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurave administrative";

V E N D O S :

1. Të pajisë sipërmarrësin "Albtelecom" sh.a. me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 2550-2570 MHz çiftuar me 2670-2690 MHz, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Sipërmarrësi duhet të fillojë shfrytëzimin e frekuencave brenda 2 (dy) muajve, nga data e marrjes së këtij Autorizimi Individual.
3. Afati i vlefshmërisë së Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 2600 MHz të fituara nëpërmjet tenderit me objekt "*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz*", Ref. *6-2x5-6x5-2016*", do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
4. Sipërmarrësi Albtelecom sh.a duhet të kryejë pagesat e kësteve sipas Kalendarit të Pagesave në Aneksin 3, pjesë përbërëse e Autorizimit Individual.
5. Moskryerja sipas afatit e pagesave me këste duke filluar nga pagesa e dytë çon në revokimin e autorizimit individual nga AKEP dhe konfiskimin e sigurimit të ofertës.
6. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____

2. **Anila DENAJ** _____

3. **Ketrin TOPÇIU** _____

4. **Klarina ALLUSHI** _____